



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.87/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nr.1192-2019, për shkak të miratimit të listës së Kryesuesve dhe Anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.09.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** i palejuar apeli Anr.87/2019 i datës 27.09.2019, i paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Nr. 1192-2019 të datës 24.09.2019, të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë.

## **A r s y e t i m**

Me datën 25.09.2019, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka paraqitur apel në PZAP, në të cilin pretendohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 24.09.2019, ka nxjerrë vendim nr.1192-2019, lidhur me miratimin e Përbërjes së Kryesuesve dhe Anëtarëve për Kuvendin e Kosovës 2019. Paraqitësi i apelit thekson se në këtë vendim përveç ndarjes së anëtarëve të Këshillave të vendvotimeve, për subjektet politike të përcaktuara në shtojcën e këtij vendimi, sipas paraqitësit të apelit, KQZ, në mënyrë kundër kushtetuese dhe në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor kanë ndarë veç e veç për secilin subjekt politik të koalicionit PAN. Paraqitësi i apelit thekson se Kushtetuta e Kosovës, nenin 84 pika 14 dhe 95 paragraf 1 dhe 5 përmend emrin parti politike ose koalicion. Në vazhdim thekson se sipas Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese Ko 119/14 pika 114, KO103/14 pika 74, si dhe KO58/19, me të cilën argumentohet se përdorimi i termave parti politike ose koalicion..., nënkuptohet partia politike ose koalicioni që është regjistruar sipas LZP-së, me të cilën merr pjesë si subjekt zgjedhor, është e përfshirë në fletëvotimin e zgjedhjeve, kalon prapin dhe kësaj fiton vend në Kuvend. Paraqitësi i ankesës ka cituar në apel edhe nenin 3 të LZP-së me të cilën përcaktohet se Subjekti apo subjektet i certifikuar politik që është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga KQZ-ja në përputhje me këtë ligj si dhe me rregullat KQZ dhe kësaj në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2017, subjekti politik PDK, AAK dhe Nisma, dhe parti të tjera kanë bërë koalicion parazgjedhor, me të

cilën sipas LZP-së dhe praktikave të Gjykatës Kushtetuese, koalicionet parazgjedhore konsiderohen subjekt politik i certifikuar nga KQZ, i cili në bazë të kësaj i takojnë të drejta dhe benificione të përbashkëta si subjekt i certifikuar. Në kuptim të kësaj LZP, në nenin 77.3 lidhur me rregullën Nr.19/2016, neni 6 par 3 përcakton se “ Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Parlamentin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë” dhe siç shihet, nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare PDK AAK dhe NISMA kanë garuar si koalicion, ndërsa LV dhe LDK kanë garuar si subjekte politike ndaras, duke fituar vende në Kuvendin e Kosovës në proporcion me numrin e votave të fituara në zgjedhjet e përgjithshme Parlamentare të vitit 2017. Në vazhdim paraqitësi i apelit thekson se, me qenë se në zgjedhjet e përgjithshme Parlamentare të vitit 2017, kanë garuar vetëm tri subjekte politike dhe të cilët kanë kaluar pragun zgjedhor, atëherë sipas nenit 77 paragrafi 3 të LZP-së, lidhur me rregulloren zgjedhore 19/2016, neni 6 paragrafi 3, vendet e rezervuara për subjektin e katërt politik për kryesues të KVV, në komunat përkatëse me shumicë shqiptare të përshkruara në vendim siç janë; Prizreni, Prishtina, Deçani, Gjakova, Peja, Kaçaniku, Gjilani, Vitia, Vushtrri, Mitrovica e Jugut, Podujevë, Obiliq, Shtime, Ferizaj, Kamenicë, Suharekë, Rahovec, Lipjan, Drenas, Skenderaj, Klinë, Fushë Kosovë, Istog, Dragash, Malishevë, Junik, Hani i Elezit, duhet të ndahen proporcionalisht nga tri subjekte politike të cilët kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit parlamentare. Sipas paraqitësit të apelit KQZ, ka cenuar rëndë Kushtetutën e Kosovës, dhe legjislacionin zgjedhor, me vendimin e nxjerr me datën 24.09.2019, sipas të cilit ka vendosur që koalicionit PAN ti ndaj secilit veç e veç numër të përcaktuar të kryesueseve të këshillit të vendvotimeve në komunat e përcaktuara në këtë vendim. Paraqitësi i apelit thekson se neni 77 paragrafi 3 të LZP-së, lidhur me rregulloren zgjedhore 19/2016, neni 6 paragrafi 3, ka përcaktuar qartë se kryesuesit e këshillave të vendvotimeve mundë të zgjidhen në mënyrë të barabarta në mesin e katër subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave, për Parlamentin e Kosovës nga zgjedhjet e fundit në atë komunë, i cili përcakton qartë se subjekti politik është edhe koalicioni PAN, i cili është certifikuar në zgjedhjet e përgjithshme Parlamentare të vitit 2017, dhe i cili ka kaluar pragun zgjedhor bashkë me subjektet politike LVV dhe LDK. Me propozim për panelin që të aprovohet apeli dhe të udhëzohet KQZ-ja, ta rishikon vendimin e saj.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

#### **Apeli është i palejuar,**

Nga shkresat e lëndës rezulton se KQZ-ja, ka marr vendim me Nr. Nr. 1192-2019 të datës 24.09.2019, ka marrë vendim lidhur me miratimin e Përbërjes së kryesuesve dhe anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit të apelit PZAP-i, iu ka drejtuar KQZ-së, për të dhënë përgjigje në raport me apelin e paraqitësit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ-ja, me anë të përgjigjes në apel ka theksuar se pas pranimit të nominimeve nga subjektet politike, dhe shqyrtimit të tyre, KQZ-ja bazuar në nenin 74, 75, 76 dhe 77, si dhe nenin 6 të Rregullës Zgjedhore nr.19/2016, për Këshillat e vendvotimeve, më datën 24.09.2019 me vendimin Nr. 1192/2019, ka miratuar përbërjen e kryesuesve dhe anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit, për zgjedhjet e datës 06 tetor 2019. Mëtej në përgjigje ka potencuar se bazuar në nenin 63 paragrafi 6 të LZP-së, nuk është në kompetencë të PZAP-it, te vendos lidhur me këtë rast ngase neni 122 i LZP-së, përcakton se për cilat lloje te vendimeve të marra nga KQZ-ja, ka juridiksion te vendos PZAP-i.

PZAP, duke vlerësuar lejueshmërinë e apelit, konstatoi se apeli është i palejuar, ngase sipas nenit 63 paragrafi 6 i LZP-së, të gjitha vendimet e KQZ-së, nuk i nënshtrohen ankesës përveç nëse përcaktohet qartë me LZP. Në rastin konkret nuk është përcaktuar qartë me nenin 122 paragrafi 1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, me të cilën dispozitë ligjore përcaktohet se cilat vendime të marra KQZ-ja, mund t'i nënshtrohen ankesës në PZAP. Po ashtu me asnjë dispozitë të LZP-së, nuk është paraparë mundësia që për vendimin e ankimuar te lejohet apel e veçantë, nga kjo rezulton se apeli është i palejueshëm, dhe nuk është në juridiksionin e PZAP-it, që të vendos për vendimet e KQZ-së, që kanë të bëjnë me emërimin e KVV-ve.

Nga arsyet, PZAP-i ,në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 87/2019 më datë 27.09.2019



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.